



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E SHTIMES
OPŠTINA STIMLJE / MUNICIPALITY OF SHTIME



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Komuna Shtime shpall:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës	Zyrtar për Shërbime Sociale 2
Klasa e pozitës	Profesional 2
Koeficienti/Paga	6.5
Nr. i kërkuar	2
Data e njoftimit	05/10/2022
Afati për aplikim	20/10/2022 - 28/10/2022
Institucioni	Komuna Shtime
Departamenti	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Divizioni	
Vendi i punës	Komuna e Shtimes, Qendra për punë sociale,
Nr. i Referencës	RN00010090
Kodi	RPC0003792



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Të kujdeset për mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror, besimin, strehimin familjar, kujdestarinë, strehimin e përkohshëm familjar
2. Të bëjë mbrojtjen e fëmijëve me sjellje asociale dhe delikvente
3. Të shqyrtojë rastet e abuzimit dhe të lënjes pas dorë të fëmijëve dhe të marrë masa dhe veprime të duhura
4. Të punojë në sanimin e marrëdhënieve të çrreguluara bashkësortore e familjare
5. Bënë propozimin për besimin e fëmijëve në raste të shkurorëzimit të prindërve përcjellë realizimin e kontakteve
6. Përcjellë rastet e dhunës në familje dhe rastet e trafikimit
7. Bënë mbrojtjen e të moshuarve dhe jep propozime lidhur me to

2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për levizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to në drejtimet: Punë Sociale, Psikologji, Sociologji, Juridik dhe ndonjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare.
- Kualifikime të posaçme formale:
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të mira metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve;
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.



5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 04/11/2022, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

- Me datë 18.11.2022, Kati II në sallën e vogël në Objektin e Komunes së Shtimes duke filluar nga ora 10:00

8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

1. Aftësi për të qenë fleksibil dhe për punë në ekip
2. Gatishmëri për të shërbyer të gjitha komuniteteve pa dallim
3. Njohja e punës me kompjuter në programet (WORD, EXCEL) është e domosdoshme
4. Gatishmëria që të punëojë punë edhe jashtë orarit të rregullt
5. Njohuri profesionale specifike në fushën përkatëse të punës, të fituara përmes arsimimit dhe trajnimeve bazike
6. Aftësi për të kuptuar dhe zbatuar praktikat operative për të përmirësuar efikasitetin
7. Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative teknike në fushën e caktuar
8. Aftësi për të punuar me vetëiniciative në kuadër të planeve dhe proceduravetë përcaktuara

9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Intervist

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.



Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

